



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT

SHPALLJE PËR POZICIONIN PËRGJEGJËS SEKTORI

Në zbatim të Vendimin Nr. 132, datë 6.3.2024, të Këshillit të Ministrave “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Ekonomisë së Mbetjeve”, si dhe të Urdhrit të Kryeministrit nr. 94, datë 12.06.2024 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë Kombëtare të Ekonomisë së Mbetjeve”.

**Përgjegjës i Sektorit të Financës & Shërbimeve Mbështetëse, në Drejtorinë
Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse, në Agjencinë Kombëtare të
Ekonomisë së Mbetjeve**

**Afati për dorëzimin e dokumenteve 28/06/2024 pranë Ministrisë së Turizmit dhe
Mjedisit**

Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin si më sipër është:

- Përcaktimi i objektivave dhe detyrave të specialistëve të sektorit, për monitorimin e veprimtarisë së tyre dhe koordinimin mes tyre;
- Planifikimi dhe zbatimi i buxhetit, si dhe mirëmenaxhimi financiar;
- Menaxhimi i aseteve të Ministrisë, të logjistikës dhe shërbimeve të tjera;

KUSHTET PËR PRANIM DHE KRITERET E VEÇANTA

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për pranim si dhe kriteret e veçanta si vijon:

- Të jetë shtetas shqiptar;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të zotërojnë diplomë të ciklit të dytë të studimeve, të nivelit “Master Shkencor” ose të barasvlefshëm me të, në shkenca Ekonomike;
- Të kenë të pakten 3 (tre) vite eksperiencë pune në profesion;
- Të mos jetë marrë ndaj tij masë disiplinore e largimit nga puna, që nuk është shuar sipas legjisllacionit në fuqi;
- Të mos jenë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;
- Të mos ketë konflikt interesi në ushtrimin e detyrës;
- Të ketë njohuri shumë të mira profesionale të çështjeve teknike dhe aftësi për të planifikuar, rishikuar dhe drejtuar punën e stafit nën varësi;
- Të ketë aftësi për të përcaktuar objektivat, vendosur prioritete dhe respektuar afatet;

- j. Të ketë aftësi shumë të mira komunikimi, prezantimi;
- k. Të ketë aftësi analitike dhe fleksibilitet në pranimin e metodave dhe procedurave të reja
- l. Të kenë aftësi të mira menaxheriale dhe të procedurave administrative;
- m. Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze;
- n. Të ketë aftësi për të përcaktuar objektivat, vendosur prioritete dhe respektuar afatet;
- o. Të ketë aftësi analitike dhe fleksibilitet në pranimin e metodave dhe procedurave të reja.

DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

- a- Jetëshkrim i aplikantit;
 - b- Fotokopje të diplomës/diplomave dhe listes se notave (përfshirë edhe diplomën bachelor);
 - c- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
 - d- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
 - e- Vërtetim të gjendjes shëndetësore (në momentin e fillimit të marrëdhënieve të punës);
 - f- Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
 - g. Dy referenca nga punëdhënës apo bashkëpunëtorë të mëparshëm;
 - gj. Certifikata për trajnime në lidhje me pozicionin për të cilin konkurojnë;
 - h- Vërtetim nga Institucioni që nuk ka mase disiplinore në vitin e fundit;
 - i- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton dokumentet e përmendura në jetëshkrimin tuaj;
- Dokumentat duhet të dorëzohen drejtpërsëdrejti në MTM brenda datës 28/06/2024

REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT TE DOKUMENTACIONIT

Komisioni Ad-Hoc do të shpallë në faqen zyrtare të MTM, www.turizmi.gov.al, tek kategoria/menjuja “Njoftimet”, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme për intervistën e strukturuar me gojë, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë kur do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme do të njoftohen individualisht (nëpërmjet adresës së e-mail), për shkaqet e moskualifikimit.

FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA

Kandidatët do të intervistohen për njohuritë mbi dokumentet e listuara më poshtë:

- Njohuri mbi Ligjin nr. 10296, datë 8.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar;
- Njohuri për Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimi e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Njohuritë mbi Ligjin nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë";

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen edhe në lidhje me:

- a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me organizimin dhe drejtimin e veprimtarisë drejtuese;
- b- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën;

MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE DHE KOMUNIKIMI

Kandidatët do të vlerësohen me pikë si më poshtë:

- a- Intervistën e strukturuar me gojë, deri në 60 pikë;
- b- Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 40 pikë.

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Njësia e Burimeve Njerëzore në MTM do të njoftojë ata individualisht në mënyrë elektronike për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail) dhe do të shpallë fituesit në faqen zyrtare të ministrisë.

Aplikimi dhe dorëzimi i të gjitha dokumentacioneve të cituara më sipër, duhet të bëhet brenda datës 28.06.2024 në protokollin e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit;

Zhvillimi i intervistës do të zhvillohet në datën 8.07.2024, në ambientet e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit;